

T'JU NDIHMOJMË TË ARRINI MË LART

HELPING YOU
REACH HIGHER
ALBANIAN
TRANSLATION

VAJTJA NË
KOLEGJ OSE NË
UNIVERSITET
ËSHTË NJË HAP
I MADH, POR KA
MBËSHTETJE NË
DISPOZICION
NËSE KENI
JETUAR NËN
KUJDESTARI.
KY ËSHTË NJË
UDHËZUES PËR
GJËRAT QË MUND
TË PËRFITONI.

Këto janë fletë FALAS
me informacion për
të rinjtë që kanë
qenë nën kujdestari,
të prodhuara nga
Become.



Mbështetja nga bashkia juaj

Plani i Udhës - Çdo fëmijë nën kujdestari duhet të ketë një Plan të Udhës¹, zakonisht duke filluar rreth moshës 16 vjeç. Kjo është si një kontratë mes jush dhe bashkisë, që përcakton se si do t'ju ndihmojë bashkia të jetoni në mënyrë të pavarur. Nëse doni të bëni një diplomë, një nivel stazhi, të bëheni mjek ose trajner basketbolli, shkruajeni në Planin tuaj të Udhës. Kontrolloni Fletën 3 me Informacion nga Linja e Këshillimit për Kujdesin për më shumë informacion se si të përfitoni nga Plani juaj i Udhës.

Këshilltari Personal - si kur ndiqni arsimin apo kur nuk e ndiqni atë, keni të drejtë të mbështeteni nga Këshilltari juaj Personal (PA) deri sa të mbushni 25 vjeç.² Pasi të keni filluar kolegjin ose universitetin, mund të telefoni këshilltarin tuaj personal për mbështetje si gjatë ashtu dhe pas semestrit.

Çdo autoritet vendor duhet të publikojë politikën e ofertës së tyre vendore dhe të të drejtave financiare për personat që kanë qenë nën kujdestari - kërkoni një kopje të të dy dokumenteve në mënyrë që ta dini se çfarë keni të drejtë të përfitoni.³



Become menaxhon Propel, një faqe interneti e cila ju lejon të kërkoni mbështetjen që ofrohet për studentët që kanë qenë nën kujdestari të cilët kanë aplikuar për kurse të arsimit të lartë në kolegjet dhe universitetet e Mbretërisë së Bashkuar. Kontrolloni atë në propel.org.uk

Bursat për Arsimin e Lartë - Ju keni të drejtë të merrni një bursë prej £2,000 nëse jeni duke studiuar në universitet, të paguar nga autoriteti juaj vendor. Kjo zakonisht paguhet me këste gjatë kohëzgjatjes së kursit tuaj.

Pushimet - Autoriteti juaj vendor duhet t'ju japë para për të jetuar gjatë pushimeve dhe diku për të jetuar nëse nuk keni strehim gjatë gjithë vitit, kur jeni në universitet. Bisedoni me këshilltarin tuaj për të mësuar se sa ofrojnë autoritetet tuaja vendore.



BECOME.
THE CHARITY FOR CHILDREN IN CARE
AND YOUNG CARE LEAVERS

PËR MBËSHTETJE DHE KËSHILLA OSE INFORMACIONE PËR TË DREJTAT TUAJA, TELEFONONI LINJËN E KËSHILLAVE PËR KUJDESHIN NË 020 7017 8901 (GJATË DITËVE TË JAVËS 10:30-15:00) OSE DËRGONI EMAIL TEK ADVICE@BECOMECHARITY.ORG.UK.

**Care
ADVICE LINE
FREEPHONE
0800 023
2033**



Become dëshiron të falënderojë Fondacionin UPP për mbështetjen e tyre bujare në prodhimin e këtij informacioni.

1. Ligji i Fëmijëve dhe Punës Sociale 2017, neni 2 dhe do të hyjë në fuqi më vonë në vitin 2018.
2. Përcaktuar në Ligjin e Fëmijëve 1989 dhe Ligjin për Largimin nga Kujdestaria 2000
3. Ligji i Fëmijëve dhe i Punës Sociale 2017, neni 3 dhe do të hyjë në fuqi më vonë në vitin 2018.
4. Huamarrja maksimale për shkollimin gjatë vitit akademik 2018/2019 në Angli, nga <https://www.gov.uk/student-finance/new-fulltime-students>
5. Huamarrja maksimale për shpenzimet e jetesës për vitin akademik 2018/2019 në Angli, nga <https://www.gov.uk/student-finance/new-fulltime-students>

Mbështetja nga universitetet, kolegjet dhe burimet e tjera

Përveç bursave për arsimin e lartë nga autoriteti juaj vendor, mund të aplikoni për një sërë grantesh, bursash dhe huash për të paguar shpenzimet e shkollimit dhe jetesës. Duke përdorur Propel, mund të zbuloni se çfarë ofron çdo universitet apo kolegji, si dhe detajet e kontaktit, në mënyrë që të mund të kontaktoni nëse keni të drejtën për të përfutur.

Huaja e studentit - Student Finance England do t'ju japë një hua për të paguar për tarifat tuaja të shkollimit (deri në £9,250 në vit)⁴ dhe një kredi për të mbuluar kostot tuaja të jetesës (deri në £8,700 në vit, ose £11,354 nëse jeni në Londër)⁵. Nuk ju duhet të filloni të paguani huatë tuaja derisa të fitoni mbi një sasi të caktuar parash. Si një person që është larguar nga kujdestaria, nëse nuk fitoni të ardhura, ndoshta do të keni të drejtën e një huaje të plotë për të dyja, tarifen e shkollës dhe shpenzimet e jetesës. Bursa juaj e arsimit të lartë nuk llogaritet si e ardhur.

Bursa për personat që largohen nga kujdestaria - Shumë universitete ofrojnë bursa në mënyrë specifike për personat që largohen nga kujdestaria - mund të shikoni se cilat universitete ofrojnë këtë lloj mbështetjeje duke përdorur Propel. Shumat ndryshojnë dhe mund të jenë nga £1,000 deri £3,000 në vit, për aq kohë sa ju kaloni në vitin e ardhshëm të kursit tuaj. Universitetet gjithashtu ofrojnë fonde për



kushte të vështira në rast se ju keni probleme për të paguar për gjërat që ju nevojiten. Ka edhe fonde për gjëra të tilla si udhëtimet dhe pajisjet e studimit. Disa do të jenë grante, të tjerat do të jenë kredi që ju duhet të paguani.

Grantet bamirëse - Fondacioni Unite (www.unitefoundation.co.uk) ofron një skemë bursash me disa universitete, që ofrojnë strehim falas për të rinjtë pa mbështetje familjare, duke përfshirë edhe ata që janë larguar nga kujdestaria. Disa organizata bamirëse ofrojnë grante për personat që largohen nga kujdestaria, siç janë Fondacioni Rees (www.reesfoundation.org), Buttle UK (www.buttleuk.org) dhe Fondacioni Spark (www.sparkfoundation.org.uk). Për më shumë informacion, lexoni fletën 1 me informacione nga Linja e Këshillave për Kujdesin e Become.

Mbështetje për refugjatët, azilkërkuesit dhe personat me leje të veçantë qëndrimi

Nëse keni status refugjati, keni të drejtën të merrni të njëjtat hua studentore sikurse studentët e Mbretërisë së Bashkuar. Ju gjithashtu duhet të pyesni për bursa dhe grante specifike në dispozicion në universitetin tuaj. Azilkërkuesit nuk kanë të drejtën të marrin kredi nga Student Finance England, por ka bursa dhe grante në dispozicion për ju. Article 26 ([26.hkf.org.uk/](https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/684826/26_hkf.pdf)) ofron bursa për studentët që kërkojnë azil - vizitoni faqen e internetit

Ka shumë mbështetje që ju ndihmojnë për të arritur gjëra të mëdha. Ju mund t'ia dilni mbanë!

të tyre për të mësuar se cilat universitete marrin pjesë. Nëse keni leje të veçantë për të qëndruar, mund të keni të drejtën të merrni ndihmë nga Student Finance England. Për këshilla, kontaktoni Just for Kids Law (www.justforkidslaw.org).

KU DO TË JETONI NËN KUJDESTARI

HAVING A PLACE TO LIVE ALBANIAN TRANSLATION

NJË UDHËZUES PËR LLOJET E VENDEVE KU MUND TË JETONI GJATË KOHËS QË JENI NËN KUJDESTARI DHE MUNDËSITË E STREHIMIT KUR LARGOHENI NGA KUJDESTARIA.

Kjo është një fletëpalosje nga një numër fletëpalosjesh FALAS me informacion për të rinjtë me eksperiencë nën kujdestari, hartuar nga organizata bamirëse Become për fëmijët nën kujdestari dhe të rinjtë që largohen nga kujdestaria.



Ku mund të jetoni kur jeni nën kujdestari

🔑 Shtëpi kujdestarie: Kjo është banesa e kujdestarëve të cilët kujdesen për ju. Mund të ketë edhe fëmijë të tjerë nën kujdestari, sikurse dhe ju. Kujdestarët tuaj mund të kenë edhe fëmijët e tyre. Ju mund të qëndroni në një shtëpi kujdestarësh për një kohë të shkurtër apo për një kohë të gjatë - punonjësi juaj social duhet t'ju tregojë se cili është plani se për sa kohë do të qëndroni aty. Kujdestarët tuaj do të punojnë ose për një autoritet vendor ose për një organizatë të quajtur agjenci e pavarur përkujdesjeje, e cila do t'ju japë atyre trajnim dhe këshilla se si të jenë kujdestarë të mirë.

🔑 Shtëpi e fëmijës: Kjo është një shtëpi e madhe me fëmijë të tjerë dhe për ju do të kujdeset një ekip i personelit. Ju do të keni dhomën tuaj dhe ka gjithashtu zona të përbashkëta për t'u çlodhur, për të ngrënë dhe për t'u argëtuar.

🔑 Vendosje nën kujdestari për pushim Kjo është kur ju shkoni për të jetuar në një vend tjetër nga vendi ku ju jetoni normalisht - për shembull nëse kujdestarët tuaj të zakonshëm janë të sëmurë ose nëse kanë nevojë të largohen për çfarëdo arsye. Kjo është vetëm e përkohshme.



🔑 Vendosje e sigurt: Ky është një vend banimi (si një shtëpi për fëmijë) që është e mbyllur. Mund t'ju duhet të jetoni në një të tillë nëse njerëzit mendojnë se ju ka të ngjarë të lëndoni veten ose dikë tjetër edhe pse qëllimi është që të jeni të sigurt, e jo të ndëshkoheni.

🔑 Kujdestari nga të afërmit: Kjo është kur jetoni me një të afërm të familjes tuaj (jo me prindërit tuaj) që është miratuar nga autoriteti juaj vendor që të jetë kujdestari juaj i afërm.



Lëvizja e papritur

Nëse ju thuhet se duhet të lëvizni nga një vend kujdestarie në një tjetër dhe nuk e prisnit këtë, atëherë është e rëndësishme të mbani mend se dëshirat dhe ndjenjat tuaja duhet të merren parasysh nga njerëzit që vendosin për lëvizjen. Nëse keni ndonjë shqetësim rreth vendosjes pas lëvizjes atëherë duhet të bisedoni me punonjësin tuaj social dhe

t'i tregoni se si ndiheni (ose këshilltarin personal nëse jeni larguar nga kujdesi por jeni nën 25 vjeç). Nëse nuk mendoni se pikëpamjet tuaja po dëgjohen, mund të kontaktoni punonjësin tuaj të pavarur të rishikimit ose të kërkon mbështetje nga një mbrojtës (shikoni fletën me informacion 2 Loja e Emrit, nëse nuk jeni të sigurt se kush janë këta njerëz dhe se si mund t'ju ndihmojnë ata).



BECOME.
THE CHARITY FOR CHILDREN IN CARE
AND YOUNG CARE LEAVERS

PËR MË SHUMË INFORMACION NË LIDHJE ME ÇDO GJË NË KËTË FLETË INFORMACIONI, KONTAKTONI CARE ADVICE LINE NË 0800 023 2033, GJATË DITËVE TË JAVËS 10:00-17:00. NE JEMI KËTU PËR TË NDIHMUAR FËMIJËT NËN KUJDESTARI DHE TË RRRITURIT QË KUJDESEN PËR TA.

**Care
ADVICE LINE
FREEPHONE
0800 023
2033**



Ku do të jetoni kur largoheni nga kujdestaria

Kur mbushni 16, punonjësi juaj social do të fillojë t'ju ndihmojë të mendoni për atë që doni të bëni kur të largoheni nga kujdesi. Ju nuk duhet të largoheni deri në moshën 18 vjeçare dhe është një ide vërtet e mirë të qëndroni nën kujdestari për aq kohë sa mundeni, me njerëz që kujdesen për ju dhe ju ndihmojnë të mendoni se ku doni të shkoni në jetë. Ligji thotë se autoriteti juaj vendor duhet t'ju ofrojë një vend të përshtatshëm për të jetuar kur largoheni nga kujdesi. Punonjësi juaj social duhet t'ju pyesë për mendimet tuaja se ku doni të jetoni dhe ata duhet të shkruajnë çdo vendim që ju dhe ata merrni për të ardhmen tuaj në një dokument të quajtur plani juaj i udhës (sigurohuni që të keni një kopje të



këtij dokumenti në mënyrë që ta dini se çfarë ju ka premtuar autoriteti vendor). Kur largoheni nga kujdestaria, vendbanimi që zgjidhni me punonjësin social ose këshilltarin tuaj personal do të varet nga vendbanimet që janë në dispozicion dhe për sa pavarësi ju (dhe ata) mendoni se jeni gati të keni. Këtu janë disa nga mundësitë tuaja:

• Të qëndroni ku jeni: Nëse jeni të rehatuar dhe të lumtur në vendosjen tuaj të vendbanimit dhe kujdestarët tuaj duan që ju të qëndroni, ju mund të kërkonti të qëndroni aty derisa të mbushni 21 vjeç. Në moshën 18 vjeçare ju do të bëheni një "person që largohet nga kujdestaria", por nuk do të ndryshojë ndonjë gjë.

• Banesat e mbështetura: Kjo është e ngjashme me 'qëndrim ku jeni', por do të jetoni me një kujdestar të ri dhe do të keni më shumë pavarësi sesa kur keni qenë në vendin tuaj të vendbanimit.

• Hollet dhe vendbanimet e mbështetura: Ngjashëm me një hotel, por shumë më të këndshme dhe për 10 deri në 100 persona. Zakonisht mund të qëndroni deri në një vit. Ato gjithashtu ofrojnë mundësi për arsimim, trajnim dhe punësim. Disa të rinj mund të vendosen në një hotel apo në një vendbanim të përkohshëm të tillë si një bujtinë, por kjo është e përshtatshme vetëm nëse jeni mbi 18 vjeç dhe duhet të jetë vetëm për periudha shumë të shkurtra kohore.

• Banesat e trajnimit/strehimi i mbështetur (nganjëherë i quajtur "gjysmë-pavarësi"): Këto janë banesa ku mund të praktikoheni të jetoni në mënyrë

të pavarur. Ato janë të ndryshme në çdo autoritet vendor, por ju mund të qëndroni atje për disa muaj ose më gjatë ndërkohë që zhvillon aftësitë tuaja për menaxhimin e një qiraje, buxhetimin dhe jetesën vetëm duke u mbështetur ende nga të rriturit.

• Vendbanimi i specializuar: Nëse keni nevojë të caktuar (për shembull, një paaftësi) që nuk mund të plotësohet nga llojet e zakonshme të akomodimit, ju duhet t'u jepet strehim që është i përshtatshëm për ju.

• Vendbanimi i pavarur: Ky është vendbanim me qira me mbështetje shtesë në qoftë se keni nevojë për të, si p.sh. këshilla financiare.

• Vendbanimi universitar: Nëse do të shkoni në universitet, autoriteti vendor duhet t'ju gjejë një vend për të jetuar gjatë festave (që mund të jetë në universitet) ose t'ju japin para kundrejt këtij vendbanimi. Ka edhe mënyra të tjera për të financuar akomodimin tuaj gjatë pjesës tjetër të kohës - shikoni fletën e fakteve 4 në këtë seri ose në faqen tonë të internetit Propel.org.uk, që jep informacion në lidhje me çfarë ofron çdo universitet për personat që largohen nga kujdestaria.

6

GJITHÇKA MBI KUJDESIN

GET TO KNOW YOUR RIGHTS

ALBANIAN
TRANSLATION

NJË UDHËZUES PËR SISTEMIN E KUJDESIT DHE ÇFARË TË DREJTASH KENI KUR JENI NËN KUJDES.

Kjo është një fletëpalosje nga një numër fletëpalosjes FALAS me informacion për të rinjtë me eksperiencë nën kujdestari, hartuar nga organizata bamirëse Become, për fëmijët nën kujdestari dhe të rinjtë e larguar nga kujdestaria.

Pse njerëzit shkojnë nën kujdestari?

Ka shumë arsye pse ju mund të keni shkuar nën kujdestari. Kjo mund të ndodhë sepse familja juaj nuk po kujdeset për ju siç duhet ose për shkak se ka ndodhur diçka e keqe në shtëpi. Cilado qoftë arsyeja, është me të vërtetë e rëndësishme të mbani mend se nuk është faji juaj dhe se shumë fëmijë shkojnë nën kujdestari. Shkuarja në kujdestari mund të jetë një kohë që ju çorodit dhe ju shqetëson pasi shpesh kjo do të thotë se të rriturit që sapo keni takuar po marrin vendime të mëdha rreth jetës tuaj, të tilla se ku mund të jetoni dhe kur mund t'i takoni prindërit ose motrat e vëllezërit tuaj. Megjithatë, mund të jetë gjithashtu një mundësi për një fillim të ri për ju. Jeta juaj do të jetë padyshim ndryshe, por shumë të rinj thonë se kanë qenë të kënaqur që janë marrë nën kujdestari dhe se ka qenë më mirë se kur jetonin me familjen e tyre.



Çfarë është “sistemi i kujdestarisë?”

Nëse jeni një fëmijë nën moshën 18 vjeç në Mbretërinë e Bashkuar dhe nuk mund të jetoni me familjen tuaj për ndonjë arsye, qeveria duhet të sigurohet se jeni të sigurt dhe për ju po përkujdesen të rritur. Ju do të shkoni nën kujdestari dhe do të përfshihen në atë që nganjëherë quhet “sistemi i kujdesit”, që do të thotë se si është organizuar kujdesi.

Cilat pjesë të ligjit ndikojnë mbi qëndrimin nën kujdestari?

Neni 20 i Ligjit për Fëmijët 1989 - Kujdesi vullnetar

Nëse jeni nën kujdestari sipas nenit 20, kjo nuk përfshin një gjykatë dhe prindërit tuaj do të kenë përgjegjësi ligjore për ju, që e ndajnë me autoritetet vendore. Kjo ndodh nganjëherë kur prindërit e fëmijës janë në burg, ose kur marrëdhëniet e një të riu me prindërit e tyre janë prishur ose kur një i riu është i pastrehë. Kjo mund të ndodhë edhe kur një i riu kërkon vetë që të merret nën kujdestari.



Neni 31 i Ligjit për Fëmijët 1989 – Urdhër kujdestarie

Kjo ndodh kur gjykata lëshon një “urdhër kujdesi” për ju, sepse ka të ngjarë që mund të lëndoheni fizikisht ose emocionalisht nëse vazhdoni të jetoni në shtëpi. Kjo do të thotë se përgjegjësia kryesore prindërore për ju është marrë nga autoriteti juaj vendor. Nëse jeni nën kujdestarinë e një autoriteti vendor, do të konsideroheni si një “fëmijë nën kujdestari” (koha afatgjatë për qëndrimin nën kujdestari) dhe autoriteti juaj vendor merr rolin e “prindit tuaj të korporatës”, që do të thotë se ata kanë përgjegjësi për ju. Si një fëmijë nën kujdestari, ka disa gjëra që ligji thotë se autoriteti juaj vendor duhet t'i bëjë për ju që të garantohet se jeni të sigurt dhe se për ju po kujdesen.



BECOME.
THE CHARITY FOR CHILDREN IN CARE
AND YOUNG CARE LEAVERS

**PËR MË SHUMË
INFORMACION
NË LIDHJE ME
ÇDO GJË NË
KËTË FLETË
INFORMACIONI,
KONTAKTONI
CARE ADVICE
LINE NË 0800
023 2033, GJATË
DITËVE TË PUNËS
10:00-17:00**

**Care
ADVICE LINE
FREEPHONE
0800 023
2033**

Pra, jeni në kujdes... cilat janë të drejtat tuaja?

Lajm i mirë është: keni shumë të drejta - prandaj sigurohuni që të dini se cilat janë ato! Këtu janë disa nga gjërat kryesore që autoriteti juaj vendor duhet të bëjë për ju:

→ të sigurohet se keni një vend të sigurt për të jetuar. (Shih fletëpalosjen numër katër për më shumë informacion rreth kësaj.)

→ Ata duhet të sigurohen që të ndiqni arsimin dhe të keni diçka që quhet një Plan Personal të Arsimit për të siguruar që nevojat tuaja arsimore të përmbushen dhe që ju të mbështeteni për të arritur qëllimet tuaja.

→ Ata duhet të plotësojnë nevojat tuaja shëndetësore - kjo përfshin shëndetin tuaj fizik dhe mendor. Nëse mendoni se keni nevojë për ndihmë për çdo gjë që ka të bëjë



me shëndetin tuaj, mbani mend se keni të DREJTËN për t'u ndihmuar. Tregojini kujdestarit ose punonjësit tuaj social.

→ Ata duhet t'ju japin një punonjës social dhe puna e punonjësit tuaj social është të sigurohet që të jeni të lumtur dhe që për ju të kujdesen mirë. Është e rëndësishme që të ndiheni të aftë të bisedoni me punonjësin tuaj social dhe t'u tregoni atyre se çfarë keni nevojë.

Punonjësi juaj social duhet:

- T'ju vizitojë të paktën çdo gjashtë javë. Kur ju vizitojnë, ata duhet të kalojnë kohë me ju dhe të njihen me ju.
- Të dëgjojnë mendimet tuaja dhe t'i marrin ato seriozisht. Ata duhet t'ju angazhojnë në vendimet për jetën tuaj. Kjo përfshin se ku do të jetoni, kush do të kujdeset për ju, arsimin tuaj, shëndetin dhe kontaktin me

familjen tuaj.

- T'ju shkruajnë një Plan Kujdesi. Ky plan duhet të marrë parasysh të gjitha nevojat tuaja, si shëndeti dhe zhvillimi juaj, marrëdhëniet familjare, ku do të jetoni, arsimin tuaj e shumë gjëra të tjera. Plani juaj i Kujdesit do të ecë me ju gjatë gjithë kohës nën kujdestari. Është dokumenti juaj ndaj është e rëndësishme t'i tregoni punonjësit tuaj social se çfarë është e rëndësishme për ju, që të shkruhet

Ju gjithashtu duhet të keni një:

Punonjës të Pavarur të Rishikimit (IRO)

- të gjithë personat nën kujdestari kanë një IRO dhe roli i tyre është të sigurohen që punonjësi juaj social po bën gjithçka që duhet për t'ju ndihmuar.

Ju po ashtu keni të drejtën:

Të bëni një ankesë - keni të drejtë të ankoheni zyrtarisht për kujdesin tuaj dhe autoriteti juaj vendor duhet t'ju tregojë se kë duhet të kontaktoni për ta bërë këtë. Filloni duke i

treguar punonjësit tuaj social se doni të bëni një ankesë. Ata më pas duhet t'ju ndihmojnë të kontaktoni një avokat dhe t'ju tregojnë se çfarë të bëni më tej.

Të keni një mbrojtës - puna e tyre është t'ju ndihmojnë që mendimet tuaja të dëgohen nëse nuk mendoni se vendimmarrësit ju dëgjojnë. mbrojtësi mund të vijë dhe t'ju ndihmojë në takimet mbi qëndrimin nën kujdestari - ata do të ndihmojnë vendimmarrësit të kuptojnë se si ndiheni dhe çfarë doni ju.